



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3158/1 të datës 03.07.2023, në lidhje me legalizimin e objektit në komunën -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për faktin se denoncimi nuk përmban të dhëna të mjaftueshme dhe nuk ka mundësi të të japë informata shtesë lidhur me pretendimet në denoncim për shkak të anonimitetit të të njëjtit.

Lënda me numër 12-3158/1 të datës 03.07.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 03.07.2023 është dorëzuar denoncim në lidhje me legalizimin e objektit në komunën ----- dhe është formuar lënda me numër 12-3158/1 të datës 03.07.2023.

Në denoncim parashtruesi thekson se Komuna ----- mundëson legalizimin e objektit pa u respektuar rregullat ligjore.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konkludoi se në rastin nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar pretendimet e denoncuar dhe nuk ka mundësi të ofrojë informata shtesë për pretendimet në denoncim (denoncim anonim), pas së cilës ka vlerësuar se ka nuk janë elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë .

Në bazë të së theksuarës më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Përgatiti: Mr. K.Z

Miratoi : K.N, anëtar i KSHPK\_së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
Nënkryetar,  
Sofka Pejovska Dojçinovska

